


Tregtia e jashtme e mallrave

Korrik 2019

Tiranë, më 19 Gusht 2019: Në Korrik 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 28 mld lekë, duke u rritur me 3,6 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 8,5 %, në krahasim me Qershor 2019. Importet e mallrave arritën vlerën 60 mld lekë, duke u rritur me 2,3 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 11,4 %, në krahasim me Qershor 2019. Deficiti tregtar i këtij muaji është 32 mld lekë, duke u rritur me 1,1 %, krahasuar me Korrik 2018 dhe 14,1 %, në krahasim me Qershor 2019.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)



Në shtatëmuajorin e parë të vitit 2019, eksportet e mallrave arritën vlerën 180 mld lekë, duke u ulur me 2,6 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 377 mld lekë, duke u rritur me 2,6 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 197 mld lekë, duke u rritur me 7,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve

Rritja vjetore e eksporteve prej 3,6 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: “Ushqim, pije, duhan” me +3,0 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,6 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +1,0 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,8 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Korrik 2019




Eksportet, gjatë këtij shtatëmujori janë ulur me -2,6 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,5 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,8 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,8 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi “Ushqim, pije, duhan” me +1,5 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve

Rritja vjetore e importeve prej 2,3%, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +1,9 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +1,0 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me +0,8 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -1,2 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Korrik 2019



Si shtatëmujor, importet janë rritur me 2,6 %, krahasuar me shtatëmujorin e parë 2018. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,6 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +0,7 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +0,3 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -0,7 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Korrik 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Korrik 2018, janë Kosova (7,3 %), Spanja (42,1 %), dhe Gjermania (17,1 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë Italia (-3,6 %), Maqedonia (-17,1 %) dhe Mali i Zi (-19,3 %).

Gjatë këtij shtatëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë Kosova (24,4 %), Gjermani (4,9 %), dhe Maqedonia e Veriut (0,5 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë Italia (-1,3 %), Spanja (-19,0 %) dhe Greqi (-2,1 %).

Në muajin Korrik 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Korrik 2018 janë Italia (2,7%), Greqia (11,0 %) dhe Turqia (4,3 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë Kina (-2,3 %), Spanja (-28,0 %), dhe Rusia (-66,6 %).

Gjatë këtij shtatëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë Kina (18,0 %), Greqia (10,3 %) dhe Turqia (6,1 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë Italia (-6,4 %), Gjermania (-10,7 %) dhe Spanja (-14,9 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Korrik 2019



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 72,2 %, të gjithë tregtisë. Në Korrik 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 83,8 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 66,7 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë Italia (38,6 %), Greqia (8,1 %), Kina (7,4 %), dhe Gjermania (6,9 %).

Shkëmbimet tregtare, për shtatëmujorin e parë 2019, me vendet e BE zënë 77,3 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Korrik 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 90,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 70,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë Italia (40,2 %), Greqia (8,7 %), Kina (8,2 %) dhe Gjermania (7,3 %)

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2017	01 - 17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04 - 17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	05 - 17	24	18,2	56	7,4	-31	43,6
	06 - 17	23	-0,1	57	9,2	-34	39,7
	07 - 17	25	9,9	55	9,6	-30	45,1
	Janar - Korrik 17	158	27,9	350	18,9	-192	45,2
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	06 - 18	27	18,1	54	-4,6	-28	49,2
	07 - 18	27	8,2	58	6,0	-31	46,0
	Janar - Korrik 18	185	16,8	368	5,0	-183	50,3
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	06 - 19	26	-4,1	53	-1,4	-28	47,9
	07 - 19	28	3,6	60	2,3	-32	46,6
	Janar - Korrik 19	180	-2,6	377	2,6	-197	47,7

Tab.2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Korrik 2018	Korrik 2019	Jan.- Korr. 2018	Jan.- Korr. 2019	Korrik 2018	Korrik 2019	Jan.- Korr. 2018	Jan.- Korr. 2019
Vendet e BE-së	20.644	21.356	142.736	137.960	34.471	35.605	228.372	225.231
Austri	92	112	1.007	1.147	630	551	3.933	4.012
Mbretëri e Bashkuar	105	48	537	422	437	499	3.374	3.142
Gjermani	1.127	1.327	8.173	8.571	3.976	4.087	28.859	25.759
Greqi	1.053	1.305	7.917	7.747	4.582	5.088	30.240	33.366
Itali	14.697	14.164	91.080	89.887	15.830	16.261	105.715	98.933
Spanjë	1.179	1.676	13.836	11.205	1.432	1.031	7.962	6.777
Kroaci	78	85	505	684	1.141	652	3.716	4.023
Të tjera të BE-së	2.311	2.639	19.681	18.296	6.443	7.436	44.574	49.220
Kinë	173	599	3.542	3.683	5.331	5.211	29.388	34.673
Kosovë	2.830	3.038	14.005	17.421	928	741	4.785	4.439
Maqedonia e Veriut	864	716	4.894	4.917	850	696	5.231	4.966
Rusi	-	4	18	74	2.534	846	7.905	5.565
SHBA	419	253	2.821	2.176	642	818	5.166	6.080
Turqi	220	235	1.100	1.216	4.593	4.789	29.773	31.598
Ukrainë	15	2	141	111	314	270	1.627	1.740
Zvicër	52	104	2.266	514	609	928	5.581	9.139
Të tjera	1.557	1.440	13.321	12.021	7.935	9.632	49.908	53.776
Gjithsej	26.773	27.747	184.843	180.094	58.206	59.537	367.736	377.208

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Korrik 2018	Korrik 2019	Jan.- Korr. 2018	Jan.- Korr. 2019	Korrik 2018	Korrik 2019	Jan.- Korr. 2018	Jan.- Korr. 2019
Gjithsej	26.773	27.747	184.843	180.094	58.206	59.537	367.736	377.208
Ushqime, pije, duhan	2.337	3.154	18.019	20.712	9.700	10.305	61.384	62.619
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	3.794	4.498	34.567	28.179	5.556	6.684	36.500	46.084
Produkte kimike dhe plastike	458	736	3.238	4.332	8.067	8.203	51.454	50.506
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	280	227	1.798	1.574	1.622	1.430	11.679	10.878
Prodhime druri dhe letre	780	862	5.069	5.583	2.424	2.548	14.176	14.650
Tekstile dhe këpucë	12.076	11.667	75.412	73.928	7.528	7.985	51.581	51.888
Materiale ndërtimi dhe metale	4.697	4.216	31.802	28.461	7.834	7.700	45.335	47.994
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	1.614	1.524	10.036	11.914	13.165	12.470	81.398	78.691
Të tjera	737	863	4.903	5.411	2.308	2.212	14.230	13.898

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Gjithsej	91.080	89.887	14.005	17.421	13.836	11.205	8.173	8.571
Ushqim, pije duhan	4.363	4.777	1.686	2.253	702	810	778	886
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	2.687	3.785	2.929	4.081	11.196	8.828	1.407	709
Produkte kimike dhe plastike	907	1.206	720	1.215	28	29	14	42
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.345	1.298	4	4	161	144	5	8
Prodhime druri dhe letre	3.533	3.814	247	473	4	3	87	94
Tekstile dhe këpucë	58.557	57.871	66	50	1.603	1.241	4.354	4.550
Materiale ndërtimi dhe metale	11.245	8.692	7.176	7.898	127	143	434	922
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	6.105	6.120	439	435	5	5	769	868
Të tjera	2.336	2.326	737	1.012	10	2	325	493

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë)

	Itali		Kinë		Greqi		Turqi	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Gjithsej	105.715	98.933	29.388	34.673	30.240	33.366	29.773	31.598
Ushqim, pije duhan	10.422	11.212	392	471	8.956	9.137	3.369	3.260
Minerale, lëndë djegëse, enerergji elektrike	7.587	4.875	5	3	4.493	7.946	471	460
Produkte kimike dhe plastike	11.020	10.945	2.879	3.205	4.589	4.578	4.742	4.477
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	8.960	8.735	422	446	44	20	176	140
Prodhime druri dhe letre	4.230	4.001	649	598	1.883	1.978	1.799	1.947
Tekstile dhe këpucë	26.349	25.095	5.532	6.601	2.231	2.213	9.156	10.103
Materiale ndërtimi dhe metale	12.735	11.641	3.904	5.788	5.218	4.905	4.242	6.086
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	20.768	19.270	12.776	14.325	1.679	1.689	4.405	3.889
Të tjera	3.643	3.160	2.829	3.236	1.147	900	1.412	1.236

Metodologjia

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejitimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikën e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifën doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri